

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A

VENDIM TEKNIK Nr. 4-T

“Çështjet teknike mbi skedarët e bisedave”

Në mbështetje të dispozitave të përcaktuara në nënseksionin G.2.2 “Regjistrimet Zanore” dhe kapitullin G.3 “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat e Tregimit të ALPEX sh.a, (në vijim referuar si “ALPEX”),

ALPEX sh.a miratoi:

1. Vendimin Teknik - Çështjet teknike mbi skedarët e bisedave.
2. Vendimi Teknik Nr. 4-T i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë - ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A

Sokol Dishnica

Neni 1

Objekti - Fushëveprimi - Përkufizimet

- a) Ky Vendim Teknik përcakton detajet teknike për instalimin dhe aktivizimin e një sistemi të posaçëm për monitorimin dhe regjistrimin e bisedave për të lehtësuar funksionimin e veprimtarive të ALPEX-it. Skedarët e monitorimit dhe regjistrimit bisedave do të kenë fuqinë e plotë të provës ndërmjet ALPEX dhe Anëtarëve të Bursës, duke lejuar kundërprovën.
- b) Regjistrimi i bisedave kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar për Shqipërinë dhe Ligjit Nr. 03/L-172 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, datë 31.05.2010 për Kosovën sipas rastit
- c) Në veçanti, dispozitat e këtij Vendimi Teknik do të zbatohen në rast të keq funksionimeve teknike apo emergjencave të tjera. Për të mbështetur Anëtarët e Bursës, ALPEX do të ofrojë shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”. Për implementimin e këtij shërbimi, ALPEX-i përdor mjete teknologjike për regjistrimin e bisedave telefonike dhe/ose Mjetin Elektronik të Emëruar në lidhje me dorëzimin e Urdhërporosive të Blerjes dhe Shitjes në emër të Anëtarëve të Bursës, të cilët e kanë të pamundur të aksesojnë Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS).
- d) Përkufizimet e këtij Vendimi Teknik kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Përkufizimet ose Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat dhe në legjislacionin përkatës lidhur me tregjet e energjisë elektrike.

Neni 2

Detaje teknike mbi regjistrimet e bisedave

- a) ALPEX-i regjistron bisedat telefonike dhe shkëmbimet e të dhënave, në veçanti kur kanë të bëjnë me dorëzimin, modifikimin ose anulimin e Urdhërporosive të Shitjes dhe Blerjes në Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, duke marrë çdo masë të mundshme të sigurisë. Këto biseda regjistrohen pavarësisht efektit ekonomik që mund të kenë mbi Anëtarët e Bursës.
- b) Përpara se ti përgjigjet telefonatës së regjistruar, ALPEX-i verifikon të dhënat e identitetit të Agjentit Tregtar të Certifikuar.
- c) ALPEX-i nuk ofron asnjë shërbim dhe në veçanti shërbimin e marrjes dhe dorëzimit, modifikimit ose anulimit të Urdhërporosive të Shitjes ose Blerjes në ETSS me anë të telefonit nëse nuk e ka njoftuar paraprakisht Anëtarin e Bursës që biseda telefonike do të regjistrohet dhe është vërtetuar që Mjeti Elektronik i Emëruar nuk funksionon.
- d) Një kopje e regjistrimit të bisedave dhe komunikimit me Anëtarin e Bursës do të vendoset në dispozicion sipas kërkesës së autoriteteve kompetente, për një periudhë

pesë (5) vjeçare. Informacioni se bisedat regjistrohen paraqitet në gjuhën në të cilën është kryer biseda.

- e) Skedarët e bisedave të regjistruara ruhen në një mjedis fiks, i cili i lejon ato të riprodhohen ose kopjohen, dhe mbahen në një format që nuk lejon modifikimin ose fshirjen e skedarit origjinal, si dhe ato ruhen në një pajisje që i lejon të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të disponueshme për Anëtarët e Bursës sipas kërkesës, vetëm një herë dhe brenda 30 (tridhjetë) Ditëve nga biseda.
- f) ALPEX do të sigurojë cilësinë, saktësinë dhe plotësinë e skedarëve të të gjitha bisedave telefonike dhe shkëmbimit të të dhënave.
- g) Numri/at e telefonit për bisedat telefonike me ALPEX-in do të postohen në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it www.alpex.al.
- h) Nuk do të lejohet kryerja e asnjë bisede nga numra të tjerë të telefonit të Agjentëve Tregtar të Certifikuar, përveç atyre të siguruar në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi më datë 07.09.2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al